

V E N D I M
Nr.136, datë 20.3.1995

PËR STATISTIKAT E BILANCIT TË PAGESAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Me propozimin e Bankës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në sistemin e statistikave të bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë bashkëpunojnë këto institucione:

- Banka e Shqipërisë
- Instituti i Statistikës- Ministria e Financave
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- Ministria e Ndërtimit dhe e Turizmit - Ministria e Brendshme
- Instituti i Sigurimeve Shtetërore (INSIG)
- Ministria e Industrisë, Transportit dhe e Tregtisë

2. Banka e Shqipërisë harton bilancin e pagesave të Republikës së Shqipërisë. Për këtë organizon dhe drejton gjithë sistemin e statistikave të bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Ajo përgjigjet dhe ka kompetenca për:

- hartimin dhe nxjerrjen e statistikave të bilancit të pagesave rregullishtë çdo tremujor;
- hartimin dhe miratimin e metodikave përkatëse të hartimit të bilancit të pagesave, duke pasur parasysh edhe praktikën ndërkombëtare;
- organizimin dhe kryesimin e Komitetit të Bilancit të Pagesave;
- mbledhjen e informacionit bazë për hartimin e bilancit të pagesave si nga entet e përfshira në këtë sistem statistikash, ashtu edhe nga ato që disponojnë ose mund të sigurojnë informacion;
- kontrollim e dokumentacionit kontabël të atyre enteve raportuese, ose të anketuara, për të cilat krijon bindjen që nuk raportojnë korrektësisht.

3. Instituti i Statistikës, si institucion i specializuar statistikor, është përgjegjës për:

- krijimin dhe zhvillimin e një nënregjistri tregtar që të përmbajë të gjitha ndërmarrjet e angazhuara në transaksione ekonomike dhe jorezidentët, që do të shërbejë si popullatë për t'u vrojtuar për qëllime të ndryshme të bilancit të pagesave nga të gjithë institucionet e përfshira në sistemin e statistikave të bilancit të pagesave; karakteristikat e këtij nënregjistri tregtar do të përcaktohet nga Instituti i Statistikës dhe Banka e Shqipërisë;

- vrojtimin e ndërmarrjeve jofinanciare;
- vrojtimin e shoqërive të transportit ajror, detar e rrugor;
- vrojtimin e operatorëve të hekurudhave;
- vrojtimin e agjentëve të shoqërive jorezidente të transportit;
- vrojtimin e enteve përgjegjëse për administrimin e aeroportëve dhe porteve detare;
- vrojtimin e ndërmarrjeve të komunikacionit;
- vrojtimin e ndërmarrjeve me investime të huaja në Shqipëri;
- organizimin dhe hartimin e pyetësorëve për vrojtimit pranë hoteleve shtetërore e private dhe shoqërive të tjera turistike në bashkëpunim me Ministrinë e Ndërtimit dhe Turizmit.

Të gjitha vrojtimit e mësipërme kryhen për qëllime të bilancit të pagesave, sipas pyetësorëve për të cilët bihet dakord paraprakisht nga Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikës.

Gjithashtu, Instituti i Statistikës furnizon Bankën e Shqipërisë me të gjitha të dhënat e vlefshme për bilancin e pagesave që disponon ose që mund të sigurojë me anë të vrojtimeve të tjera që nuk përmenden më lart.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për furnizimin e Bankës së Shqipërisë me të dhënat e tregtisë së jashtme (eksport-import) në detajet dhe format e duhura që plotësojnë qëllimet e bilancit të pagesave dhe për të cilat bihen dakord paraprakisht mes Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave furnizon Bankën e Shqipërisë me të gjithë të dhënat e vlefshme për bilancin e pagesave që disponon, ose që mund të sigurojë me anë të vrojtimeve e raporteve nga sistemi i saj i zyrave doganore.

5. Ministria e Financave është përgjegjëse:

- për mbledhjen e raportimin periodik të të dhënave për shërbimet qeveritare dhe të tjera veprimtari që klasifikohen në to;
- për mbledhjen dhe raportimin periodik të informacionit për borxhin e jashtëm dhe detyrimet e tjera kundrejt jorezidentëve;
- për sigurimin e çdo informacioni tjetër të vlefshëm për bilancin e pagesave, si për shembull, transfertat pa shpërblim etj.

Këto informacione raportohen rregullisht çdo tremujor me anë të formularëve të hartuar nga Banka e Shqipërisë.

6. Ministria e Ndërtimit dhe e Turizmit organizon dhe kryen vrojtime:

- për hotelet shtetërore e private;
- për shoqëritë e tjera turistike, përveç hoteleve, p.sh. operatorët turistikë;
- për vizitorët në mbërritje ose para nisjes.

Në rast se vrojtmet e mësipërme kryhen për qëllimet e vetë ministrisë, atëherë në to integrohen elemente shtesë që sigurojnë informacion për bilancin e pagesave. Në të kundërt vrojtmet kryhen me pyetësorë të posaçëm të bilancit të pagesave, për të cilët bihet dakord paraprakisht nga Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit. Pyetësorët duhet të sigurojnë informacion për profilet e grupeve të ndryshme të udhëtarëve, detaje për shpenzimet e tyre në Shqipëri dhe kohën e qëndrimit.

Ministria e Ndërtimit dhe e Turizmit furnizon Bankën e Shqipërisë me të dhëna të tjera të vlefshme për bilancin e pagesave që disponon ose që mund të sigurojë me anë vrojtimesh e raportesh të ndryshme nga ato që përmenden më lart.

7. Instituti i Sigurimeve Shtetërore INSING raporton:

- të dhëna të agreguara për premiot e tregtisë së jashtme dhe për lloje të tjera sigurimesh për jorezidentët:

- arkëtimet nga pretendimet për risigurimet e siguresve të huaj;
- pagesat për pretendimet e jorezidentëve dhe për risigurimin (premio, pretendime).

Ky informacion raportohet rregullisht nëpërmjet një formulari tremujor të hartuar nga Banka e Shqipërisë.

8. Ministria e Brendshme furnizon Bankën e Shqipërisë me të dhëna mujore të agreguara për tregues të tillë, si numri i personave që hyjnë e dalin në kufijtë e Republikës së Shqipërisë, ndarë sipas kriterëve të rezidencës, rajoneve kryesore të origjinës, qëllimit të udhëtimit dhe kohës së qëndrimit.

Gjithashtu, Ministria e Brendshme furnizon Bankën e Shqipërisë me të gjitha të dhënat e vlefshme për bilancin e pagesave që ajo disponon.

9. Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Transportit furnizon Bankën e Shqipërisë me të dhënat për shërbimet e transportit të mallrave e pasagjerëve sipas detajeve dhe formave të duhura që plotësojnë qëllimin e bilancit të pagesave dhe për të cilat bihet dakord paraprakisht mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Industrisë, Tregtisë dhe Komunikacionit.

10. Afati i raportimit të të gjitha institucioneve të mësipërme në Bankën e Shqipërisë caktohet në formularët përkatës të Bankës së Shqipërisë të përgatitur për çdo institucion.

11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore të caktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi